

RELACION – TEKNIK

PER

SISTEMIN E MBROJTJES DHE SHPETIMIN
NGA ZJARRI

OBJEKTI : “RIKONSTRUKSION I SHKOLLES 5-DESHMORET ,KSAMIL”

POROSITESI : BASHKIA SARANDE

TE DHENA TE PERGJITHSHME

Objekti "Rikonstrukcion i shkolles 5-deshmoret ,Ksamil"

Sheshi para objektit do te jete i shtruar dhe I regulluar sipas kondicioneve urbane dhe ato te sherbimit zjarrfikese, e qe do ta bejne me te kenaqshem qendrimin ne te te pushuesve. Ne te dy pjeset anesore te objektit do te kete vend per vendosjen e makines zjarrfikese ne raste zjarri. Ne afersi te objektit nuk ka ndertesa te tjera te cilat mund te perbejne rrezik per zjarr.

Objekti pershkohet rreth e rrotull me rruge ne dy anet e saj ,per levizjen dhe manovrimin e lirshem te makinave te sherbimit zjarrfikese dhe atyre te urgjences.

Hyrja per ne sheshin e objektit do te behet nepermjet hyrjes kryesore te objektit e cila eshte rreth 6 m e gjere. Ne raste zjarri kjo rruge dhe oborri rreth e rrotull saj bejne te mundur afrimin e automjeteve te sherbimit zjarrfikese. Objekti do te paiset me leje ndertimi te dhena nga Keshilli i Rregullimit te Teritorit te Bashkise Sarande.

Detyrat e lena nga sherbimi zjarrfikese si ne fazen e lejes se sheshit duhen zbatuar plotesisht. Objekti eshte nje godine 2 kateshe dhe eshte projektuar per sherbim dhe banim. Ne perberje te tij ka:

Ne katin perdhe eshte ambjent sherbimi.

Ne katin e 1 te jane ambjente sherbimi.

“ Objekt me rrezikshmeri te shtuar per renie zjarri “

Ne plan vendosjen e ketij objekti, duhen respektuar normat dhe kushtet teknike te percaktuara ne " Rregulloren e Urbanistikes " ne raport me objektet e tjera ne afersi te tij. Ne afersi te ketij objekti nuk do te kete ojekte me rrezikshmeri te theksuar shperthimi, si qendra te gazit te lengezuar te naftes, te karburanteve ose reparte prodhimi apo magazinimi te lendeve shperthyese. Vendvendosja e objektit ne raport me infrastrukturen rrugore do te jete shume e pershtatshme.

- Godina duhet te kete nje dalje emergjence (pervec shkalleve, shkalle te objektit) per cdo kat te cilat perdoren vetem ne raste zjarri apo emergjence te tjera.

Niveli i rrezikut.

Ndertesa ne te gjitha katet e saj , eshte parashikuar dhe do te perdoret per banim. Ne keto kushte ambjentet e saj te brendshme do te kene nje kompletim normal dhe te kohes me mobilje, paisje zyrash, paisje guzhine dhe orendi shtepiake.

Ne perberjen e pajisjeve mobiluese do te kete lende e materiale prej druri, fibrash plastike, lekure, tekstili etj. Ngrohja e mjedisit mund te jete me kondicioner ndersa gatimi ne guzhinen e restorantit do te behet me gaz te lengshem. Ndertesa eshte projektuar dhe do te zbatohet me konstrukcion te padjegshem.

Ngarkesa e zjarrit d.m. th potenciali termik i te gjitha materialeve te djegshme ne ambjentet e cdo kati te nderteses, duke perfshire ketu edhe veshjet e mureve, dhe tavanet, do te jete ne nivelin 25 - 50 kg per 1 m² siperfaqe dyshemeje.

Ne keto kushte sasia e materialeve te djegshme do te jete e tille qe mund te kemi zjarre te dimensioneve te moderuara, prandaj ambjentet e nderteses per akomodim paraqesin rrezik normal dhe, nga normat e mbrojtjes nga zjarri e shpetimit, do te klasifikohen si veprimtari te kategorise C te rrezikut per zjarr dhe eksplozion.



KERKESAT LIGJORE DHE ATO TEKNIKE PER MBROJTJEN NGA ZJARRI

Ne masat e parashikuara per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin do te mbahen parasysh:

Sigurimi i jetes se njerezve ne ambientet akomoduese te godines. Kjo realizohet nepermjet zbatimit te kerkesave ligjore dhe normave te mbrojtjes nga zjarri sipas standarteve te percaktuara per keto kategori objektesh.

Konkretisht ato jane te pasqyruara:

Projekti per Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpetimin i objektit "Godine banimi 2-kate" eshte realizuar ne baze te standarteve dhe normave lokale si dhe ato te vendeve te Komunitetit European. Sistemi i mbrojtjes kunder zjarrit respekton te gjitha kerkesat e detyrueshme shtetore qe kane te bejne me normat / standartet qe jane ne fuqi aktualisht ne Shqiperi si dhe normat Europiane. Ligjet, rregulloret, normat dhe standartet e perdorura ne kete projekt jane paraqitur ne vijim:

- Ligji nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimit";
- Rregullore "Mbi masat e mbrojtjes kunder zjarrit ne projektimin e ndertesave te cdo lloji "Vendim nr.162 date 19.4.1965, e ripunuar;
- Udhëzim i Ministrisë së Punëve të Brendshme nr.425 date 24.7.2015 "Per pranimin, administrimin e dokumentacionit teknik dhe grafik te projektit te mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin dhe leshimin e akteve teknike";
- Urdher nr.45 date 09.04.2004 "Mbi rruajtjen e vlerave materiale nga zjarri ne depo dhe magazina";
- EN 13501 Fire classifications of construction products and building elements (all parts) - IEC 79-10 Area Classification Guidelines - EN 2 Classification of fires
- EN 1838 Lighting applications
- Emergency lighting - EN 1366 Fire resistance tests for service installations
- NFPA 10: Standard for Portable Fire Extinguishers, 2010 edition.
- BS EN B2:Fire Safety – Buildings other than Dwelling houses – Volume 2

SISTEMI ZJARRFIKES I UJESJELLESIT

Objekti : *"Rikonstruksion i shkolles 5-deshmoret ,Ksamil"*

do te ndertohet nje sistem zjarrfikes i cili perfshine :

- rezervuaret nentokesore te ujit per sistemin e hidranteve e sprinkler (do te jene konforme rregullave dhe me kapacitetin e nevojshem per fikjen e zjarrit).
- furnizimi me uje i rezervuareve do te behet nepermjet pusit artezan dhe rimbushja e tij e plote te realizohet per disa ore.
- tubacionet e kalimit te ujit nga linja tek rezervuaret e zjarrfikeses duhet te jene me diameter , 50-70mm.
- rezervuaret do te jene ne bodrum per sigurimin e furnizimit te pandërprere me uje te sistemit shuares ne rast zjarri.

Ne kete sistem ujesjelles, presioni i nevojshem per shuarjen e zjarrit nepermjet hidranteve zjarrfikes (te brendshem) si dhe sistemit automatik shuares " sprinkler " do te krijohet me ane te ciftit te pompave te llogaritura qe do te instalohen posacerisht vetem per fikjen e zjarreve dhe do te jene te vendosura ne ambientin e bodrumit te objektit.Ne dhomen e sherbimit do te jene vendosur 3 rezervuar uji me kapacitet secili nga 5.000 l uje.

Tubacionet Dhe Rakorderitë

Tubacionet dhe rakorderitë që do të përdoren do të jenë në përputhje me normativat e mëposhtme:

- tubacione çeliku S235JR dhe Fe360 sipas UNI 10025, UNI EN 10029;
- brylat, kthesat dhe trashësite e mureve sipas UNI EN 10024;
- mbërthyesit dhe vida/bulona CE, sipas UNI 5727; - manikotat antivibrantë me flanxha çeliku sipas UNI EN 1092-1;
- lyerja e jashtme kundër korrozionit me sprucim (Catramina HD), me spesor minimal ≥ 150 mikron, referuar UNI 12845;
- lyerja në zonën e ujit kundër korrozionit nëpërmjet sprucimit të catrame epossibituminoz bicomponente EPOXITAR, me spesor minimal ≥ 150 mikron, referuar UNI 12845;
- lyerja në zonën teknike me antiruge dhe trajtim i metejshëm me epossidoc bicomponent EPOX i Zinkuar, në përputhje me UNI 11292

Kapaciteti i rezervuarit llogaritet :



- 5 lit / sek per nje hidrant te jashtem zjarrfikes;
- 2 x 2,5 lit / sek per venien ne pune te 4 hidranteve te brendshem zjarrfikes;
- intensiteti i dhenies se ujit nga sistemi automatik “ sprinkler “ 0,1 lit / sek per 1 m² siperfaqe dyshemeje.

Kaseta hidranti do te vendosen nga 1 ne secilin kat te hotelit (shiko skemen).



  diametri DN 32;45;52

  presioni i punes 4 atm;

  tubi zjarrfikes me gjatesi 20 -25m;

  rryma e ujit 30 m;

  mbulimi i te gjithe siperfaqes te objektit;

  karakteristikat teknike e pajisjeve te plotesoje kushtet e percaktuara te standarteve te emergjences.



SISTEMI I FIKSAVE TE ZJARRIT

Ne katet: perdhe,katin 1 duhet te kete nga 2 fiksa zjarri CO2 per secilin kat,me kapacitet 6 kg,qe duhet te vendosen njeri ne fillim e tjetri ne fund te korridoreve perkatese.

SISTEMI I POMPAVE ZJARRFIKESE

Normat e mbrojtjes nga zjarri dhe te shpetimit per njesite akomoduese klasifikohen ne kategorine B dhe C per rrezikshmerine e zjarrit e te shpetimit percaktojne :

  garanci te furnizimit me uji per 1.5 ore luftim;

  sistem elektrik ose elektronik te futjes ne pune automatikisht (me renie presioni) dhe manuale;

SISTEMI I DIKTIM SINJALIZIMIT

Ne projektimin e objekteve akomoduese me rrezik te shtuar per renie zjarri dhe shperthimi, kategoria B dhe C , sikurse do ti kemi ne kete hotel, parashikohet kompletimi me sisteme diktim sinjalizimi.

Formimi i tyre bazohet ne :

👉👉 rrezikshmerine qe paraqesin keto procese pune per jeten e njerezve;

👉👉 marrjen e nje informacioni sa me te shpejte ne kohe dhe diktimin e vatres te shfaqjes se zjarrit;

👉👉 evitimin maksimal te procesit te zhvillimit e te perhapjes se zjarrit dhe te efekteve te tij negative ne :



Bazuar ne argumentat e lartepermendur si dhe ne kerkesat ligjore dhe ato teknike per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin, ne te gjithe objektin eksperti i zjarrit konstatoi se projekti i tij eshte bere konforme rregullave te mbrojtjes nga zjarri e shpetimit,dhe zbatimi i tij duhet te behet po konform ketyre rregullave.

Te dhenat teknike dhe pjeset perberese te ketije sistemi jane :

- sistemi do te jete i tipit te adresuar, me seksione sipas kateve te nderteses dhe reparteve te sherbimeve ;
- do te jene te relizuara me central dhe monitore;
- dedektoret do te jene qe te veprojne nen efektin e tymit ose te kombinuar;
- sipërfaqia e mbulimit e nje koke dedektuese do te jete 30 – 40 m².

Ne **katin perdhe** do te kete nga 1 dedektore ne cdo ambient.
Ne **katin e 1** do te kete nga 1 dedektore ne cdo dhome. Te gjithë dedektoret do te vendosen sipas skemes se projektit.

Ambientet akomoduese te hotelit, zyrat e ambientet e shermimeve.

Do te kene perkatesisht siperfaqe te ndryshme dhe do te jene te pajisura me materiale te ndryshme. Lendet dhe materialet me rrezikshmeri zjarri te pranishme ketu do te jene : druri me te cilat do te jene pajisur dhoma gjumi, dollape, krevate, dritare, materiale sintetike, sfungjeri, copa beze e sintetike, fibra te llojeve te pershtatshme per te pajisur keto objekte akomoduese. etj. Materialet me perberje druri paraqesin rrezikshmeri relativisht te larte per zjarr.

Materialet prej druri, po te ngrohen ne temperatura 270 – 280 grade celcius, ndizen dhe vazhdojne te digjen ne menyre te pavarur.

Nga djegia e 1 kg lende drusore clirohen 4,4 metra kub produkte djegie.

Gjate djegies ato clirojne nxehtesi dhe temperatura te konsiderueshme. Temperatura e flakes gjate djegies se drurit arrine deri ne 900 grade celcius. Zjarret ne materialet drusore perhapen me nje shpejtesi relativisht te madhe qe arrine 1-3 m / min.

Materialet karton dhe leter kane rrezikshmeri me te larte se ato drusore. Temperatura e vetendzjes eshte 184 oC, shpejtesia e djegies 0,6 m / min.

Nga djegia e 1 kg leter apo karton clirohen 4,2 deri ne 5 metra kub produkte djegie.

Materialet prej kartoni, ne vecanti te perdorura si kuti te mbushura me mallra te ndryshme, e shtojne rrezikun e renies se zjarrit edhe per efekt te konfiguracionit te tyre apo menyres se vendosjes.

Ato shtojne ngarkesen specifike te materialeve te djegshme, cka nenkupton ne rast zjarri deme me te medha materiale dhe temperatura mund te arrije ne kufijet e 1000 deri 1200 o°. Kjo temperature vepron ne strukturat e objektit e mure.

Tekstilet dhe materialet e veshjeve ne dhomat e akomodimit.

Ne teresi materialet e tekstilit perbehen nga fibra natyrale ose sintetike.

Shkalla e djegshmerise se ketyre materialeve eshte teper e larte. Ato ndizen lehte, ne vacanti ne siperfaqe, sidomos kur jane ne gjendje te hapur.

Ndersa kur ato jane ne dengje, djegia siperfaqesore eshte e shpejte, por ajo ne thellesi vazhdon edhe me ore te tera, duke cliruar sasi te medha tymi mbytes.

Nga djegia e 1 kg materiale pambuku te shkrifet ose sintetik clirohen 4,5 – 5 m³ produkte djegie.

Te dhenat teorike tregojne se shpejtesia e djegies ne keto materiale kur jane ne gjendje te shkrifet arrine ne 0,24 kg per minute per 1 m² siperfaqe. Kompletimi i dhomave te hotelit me artikujt si divane, kolltuqe etj kane nderthurje te disa lendeve si dru, sfungjer, beze, mbulesa prej materialesh fibroze e sintetike etj, cka e shton rrezikun e zjarrit.

Keshtu ne kushtet e nje zjarri te ndodhur, faktor i te cilit eshte edhe rrezatimi i flakes dhe intensiteti i saj, kur ke nje mase prej 100 k/kal per meter katrore siperfaqe ne minute, brenda 10 minutave realizohet ndezja e fijeve prej pambuku ose te perzjera me ato sintetike.

Shpejtesia e perhapjes se flakes, vec faktoreve te tjere varet edhe nga ngarkesa specifike. Ne kushte normale me keto materiale ajo arrine deri ne 30 – 40 cm / min.

Relacionit të Projektit Elektrik të MKZ-së

Projektimi, prezenca dhe mbajtja në gadishmëri pune e sistemit elektrik, ndriçimit të rrugëve të evakuimit, perceptimit të zjarrit dhe sistemeve paralajmëruese të instaluar në godinë janë të nevojshme për t'u mos dëmtuar njerëzit që gjenden në godine në rast zjarri apo në çdo lloj rasti emergjence, për të parandaluar panikun, për të mundësuar boshatisjen e parkimit dhe për të siguruar një ambient të sigurtë. Për çdo pajisje elektrike është kusht që të projektohet dhe të ofrohet në përputhje me standartet dhe rregulloret e sistemeve të ndriçimit të rrugëve të evakuimit, orientimit, ndriçimit në rastet emergjente, perceptimit të zjarrit dhe sistemit të paralajmërimit. Energjia e të gjithë sistemeve dhe pajisjeve që përdoren në kuadrin e skenarëve të zjarrit në parkim apo tërmete, do të ndahet e veçantë si “energji për raste emergjente” dhe do të trajtohet nëpërmjet paneleve të veçantë. Energjia e parashikuar jashtë këtij kuadri duhet të jetë e ndarë dhe e gatshme për t'u ndërprerë në mënyrë manuale kur kërkohet. Elementët ku nevojitet energji emergjence do të jenë si më poshtë: - pompat e sistemit të mbrojtjes nga zjarri; - energjia që ushqen sistemet e detektimit të zjarrit, të sistemeve të kontrollit të sigurisë; - sistemi i thirrjes për raste emergjence dhe njoftimet flash nëpër kate (sirenat flash dhe ato të alarmit).

Relacionit të Projektit Konstruktiv të MKZ

Nga ana konstruktive, objekti *“Rikonstruksion i shkolles 5-deshmoret ,Ksamil”*

është projektuar me elementë konstruktive të padjegshëm dhe struktura ndarëse të tipit R90. Edhe ndarjet e kompartimenteve të parkimit me ambjentet teknike do të jenë të tipit jo më të ulët se REI90. Shkallët e largimit do të jenë të realizuar me struktura të padjegshme të tipit të paktën REI120 dhe të pajisura porta të tipit të paktën REI120 me vetë-mbyllje. Për të rritur garancinë për jetën e njerëzve të pranishëm, kur ata ndodhen në kushtet e një zjarri dhe për të bërë të mundur një evakuim të shpejtë dhe të sigurtë të tyre nga vendi i ndodhjes është e detyrueshme që daljet dhe rrugë kalimet evakuuese, sidomos hapsirat dhe kalimet në to të mbahen gjithnjë të lira. Ato bëhen prezent edhe nëpërmjet tabelave treguese fosforeshente dhe me ndriçim. Në këtë mënyrë, masat e përgjithshme pasive të mbrojtjes nga zjarri përfshijnë edhe:

- pozicionimin e shenjave në vende të dukshme dhe vendosjen e instruksioneve për veprimet që duhet të kryejë personeli në rast zjarri;
- pozicionimin e shenjave që paraqesin pozicionet e fikëseve të zjarrit dhe hidrantëve, rrugët e largimit dhe daljet e emergjencës;
- largimin e materialeve të ndezshme nga ambjentet e parkimit dhe vendosjen e tyre vende të sigurta për parandalimin e transmetimit të zjarrit;
- mbajtjen të lirë të rrugëve të largimit; - mirëmbajtjen e kujdesshme dhe kontrollin e vazhdueshëm të instalimeve elektrike në përputhje me rregullat përkatëse për instalime të tilla;

- inspektimin nga një personel i kualifikuar dhe trainuar i të gjitha kompartimenteve, magazinave, etj. gjatë gjithë kohës për eliminimin e kushteve që mund të çojnë në krijimin e një zjarri.

Materialet me perberje gome-plastike

Paraqesin rrezik ne perhapjen dhe ne zhvillimin e zjarreve eventual. Kjo ndodh pasi plastikat ndizen dhe digjen lehtesisht.

Ne temperatura mbi 100 grade celcius, plastikat zbuten, me tej ato shkrijne, dekompozohen dhe vashdojne te digjen si nje leng qe merr flake. Theksojme se kur materialet plastike ndodhen ne siperfaqe te pjerreta ose te perdorura si veshje dekorative, gjate djegies ato shkrijne dhe rrjedhin ne dysheme.

Gomat (ne rastin tone gomate e automjetit ne parkim) konsiderohen me rrezikshmeri shume te larte per zjarret. Ato digjen me lehtesi dhe clirojne nxehtesi dhe tym te madh. Gjate djegies se gomave dhe plastikave temperatura e flakes arrine 1,100-1,200 grade celcius.

Nga djegia e 1 kg lende plastike clirohen 10,80 metra gub produkte djegie. Shume materiale plastike, gjate djegies se tyre clirojne avuj dhe gaze helmuese.

Sinjalistika Dhe Ndricimi I Emergjencës

Tabelat e sinjalistikës duhet të jenë në përputhje me normat UNI 7543 DIN 4818 dhe në përputhje me direktivat CEE dhe normat 150/80. Ato do të jenë të tipit luminishente të realizuara në laminat plastik me spesor 3mm, fotoluminishente dhe të tipit fosforeshent. Dimensionet minimale të tabelave të sinjalistikës do të jenë 250x250mm për tabelat kuadratike dhe 320x250mm për tabelat drejtkëndore. Sistemi i ndriçimit në raste emergjence do të rregullohet që të ofrojë ndriçim të mjaftueshëm duke hyrë në veprim automatikisht në rastet kur ndërpritet furnizimi me rrymë nga rrjeti publik apo ndonjë rrjet të ngjashëm të jashtëm, në raste zjarri, tërmeti etj., ose për shkak të ndërprerjes së rrymës për ndonjë arsye sigurie dhe ndërprerjes së rrymës nga një rënie siguresë si pasojë e një qarku të shkurtër. Ndricimi emergjent do të ofrohet pergjate 2 oreve kur ndërpritet furnizimi me energji elektrike. Elementët e ndriçimit ne rrugët e evakuimit do të vendosen në lartësinë e përshtatshme dhe niveli i ndriçimit emergjent në çdo pikë platforme ku ecet do të jete minimalisht 1 lux. Në fund të periudhës së punës emergjente niveli i këtij ndriçimi në çdo lloj pike nuk do të bjerë në një nivel më të ulët se 0.5 lux. Elementët e orientimit në rastet emergjente do të jenë të llojit që ndizen vazhdimisht, edhe nëse atyre iu ndërpritet ndriçimi normal ato do të vazhdojnë të qëndrojnë ndezur edhe 2 orë të tjera minimalisht. Tabelat e orientimeve do të jenë me fushë të gjelbërt dhe shkrim të bardhë, në përputhje me standartet perkatese. Distanca maksimale e shikueshmërisë së një shenjë orientuese kushtëzohet nga kërkesa që kjo distanca të jetë jo më e madhe se 200 fishi i lartësisë së dimensionit të shenjës. Distanca mes shenjave orientuese do të jetë max. 60 m.

Në rrugët e evakuimit nuk do të gjendet asnjë shenjë tjetër me dritë pervec atyre orientuese, në mënyrë që të mos krijohet asnjë mëdyshje në lidhje me drejtimin e largimit. Shenjat orientuese do të jenë të shikueshme nëpër rrugët e largimit si në kohë ndriçimi normal si në ndriçim emergjent.

Gazi i lengezuar i naftes

Gazi i lengezuar i naftes do te perdoret ne guzhine nepermjet sistemit te ngrohjes me gaz. Dihet se ai eshte i tipit butan, propan ose perzjerja e ketyre dy gazeve. Ne gjendje te lenget ato jane pa ngjyre, avujt e tyre jane afersisht 1,5 deri 2 here me te rende se ajri. Temperatura e ndezjes e tyre eshte mesatarisht 450 grade celcius.

Faza e gazet e gazit te lengezuar kur perzjehet me ajrin ne raporte nga 1,5 deri ne 9,5 perqind shkakton eksplozion. Temperatura e flakes gjate djegies se ketyre gazeve arrine nga 1980 deri ne 2008 grade celcius. Vec rrezikut per zjarr dhe eksplozion, gazi i lengshem shkakton te njerezit anestezi dhe asfiksi, si dhe demtime serioze ne qofte se lengu bie ne kontakt me lekuren e trupit te njeriut.

Faktoret me ndikim pozitiv.

Objekti *“Rikonstruksion i shkolles 5-deshmoret ,Ksamil”*

do te jete me element konstruktiv te padjegshem. Ne ambientet e dhomave zjarri mund te lind dhe te zhvillohet vetem ne lendet dhe materialet e djegshme qe ndodhen ne brendesi te tyre. Strukturat ndertimore te nderteses nuk digjen.

Ato i qendrojne zjarrit pa u shkaterruar, ne nje afat kohor qe eshte i barabarte me kufirin minimal te qendrueshmerise ndaj zjarrit qe ka secila strukture ndertimore e saj. Brenda kesaj kohe njerezit do te kene mundesi te largohen nga ndertesa pa rrezikuar jeten e tyre dhe njeherazi te veprohet me efektivitet per shuarjen e tij. Instalimet elektrike nuk do te perbejne shkak per renien e ndonje zjarri, pasi ato jane parashikuar dhe do te realizohen konforme normave teknike, ne pershtatje me natyren e ambienteve dhe me rezerva te konsiderueshme per mbajtjen e ngarkeses. Sistemi elektrik do te kete boks me vete me kontatore, katet do te kene kuader me vete, po keshtu guzhina e ambientet e sherbimit . Percjellesit do te jene kabell bakri me izolim dhe veshje PVC sipas standarteve e normave .

Qendrueshmeria kundrejt zjarrit dhe grupi i djegshmerise

Ne nenet e rregullores “Mbi masat e mbrojtjes nga zjarri ne projektimin e ndertesave te cdo lloji” percaktohen keto norma te mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi:

1-veprimtarite e kategorise c te rrezikut te zjarrit, lejohen ne ndertesat eshkalles se I-re dhe te II-te te qendrueshmerise ndaj zjarrit. Kjo eshte **shkalla e kerkuar sipas normave.**

2-numri i kateve dhe siperfaqes maksimale e lejuar ndermjet mureve mbrojtese nga zjarri per ndertesat e shkalles se pare eshte i pakufizuar.

Kushtet e sigurise ndaj zjarrit.

Duke i krahasuar te dhenat faktike me ato te kerkuara sipas normes, te cilat jane parashtruar me larte, mund te konkludojme :

1. Grupi faktik i djegshmerise i strukturave te ndertimit dhe i vet ndertesese do te jete i padjegshem.
2. Kufiri minimal faktik i qendrueshmerise ndaj zjarrit i strukturave te ndertimit do te jete me i larte se kufiri minimal i qendrueshmerise i normuar.
3. Shkalla faktike e qendrueshmerise ndaj zjarrit e ndertesese do te jete me e larte se shkalla e normuar.
4. Per ndertesat e akomodimit te shkalles se II-te te qendrueshmerise ndaj zjarrit te ndertesese, nuk ka kufizim ne numrin e kateve. Per ndertesat e banimit te shkalles se II -te te qendrueshmerise ndaj zjarrit te ndertesese, nuk ka kufizim as ne siperfaqen maksimale te lejuar te katit.

Si perfundim theksojme se : plotesohen te gjitha kushtet e sigurise nga zjarri, sipas kerkesave dhe gjendjes ne fakt te zbatimit te normave te mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimit

Evakuimi i detyruar i njerezve ne rast zjarri.

Ne **katin e pare** si dalje per evakuim do te jene: hapesirat e dyerve te cdo dhome, koridoret e perbashketa dhe shkallet ne zbritje nga katet perkatese per ne katin perdhe.

Ne **katin perdhe** si dalje do te sherbejne hapesira e daljes kryesore nga ndertesa. Pas daljes kryesore grumbullimi i njerezve do te behet ne 1 shesh te percaktuar qe me pare. Gjeresia e hapesirave te daljeve evakuese do te jete 90-100 cm dhe 120-150 cm per daljen nga ndertesa.

Ndersa **si rruge evakuese**, per largimin e detyruar te njerezve ne rast zjarri, nga vendi ku ndodhen ne ate moment, ne drejtim te daljeve evakuese, jane : hapsirat ne brendesi te ambjenteve te vacanta, koridoret e brendshme te perbashketa dhe shkallet ne zbritje, nga katet e siperme ne katet e me poshtme deri ne katin perdhe. Largimi i njerezve do te behet sipas largesise se vendodhjes se tyre, dhe si orientim jane shenjat treguese fosforishente. Gjeresia e rruge kalimeve per evakuim eshte : koridoret e perbashketa me gjeresi 140 - 160 dhe shkallet normale 120 cm. Ne hotel nuk parashikohet te kete me shume se 80-100 njerez ne te e njejten kohe. Sipas normes, gjeresia e rrugeve dhe e daljeve te planifikuara per evakuim do te jete 167 njerez per 1 meter gjeresi. Me keta tregues jemi brenda kerkeses te normave te mbrojtjes nga zjarri per evakuimin e detyruar te njerezve ne rast zjarri.

Normat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimit, gjatesine e rrugeve te evakuimit ne te tilla ndertesa dhe ne te tilla aktivite e lejojne deri ne 40-45 metra.

REKOMANDIME

1- Sistemet e sigurise per shuarjen e zjarrit, i diktim sinjalizimit, i alarmit etj. te instaluara **duhet te** vihen ne prove per mirefunksionimin e tyre.

2 – Personeli i (objektit) **duhet te** studjose dhe ruaje dokumentacionin teknik te ketyre sistemeve dhe te kontrolloje gatishmerine e tyre ne perputhje me afatet e garancise.

3 – Personeli teknik e administrativ dhe punonjesit **duhet te** trajnohen paraprakisht per njohjen dhe venien ne funksionim te sistemeve te sigurise

Ne rast defektesh apo mos funksionimi nderhyrjet do te behen vetem nga specialistet e saj.

4 – Punonjesit **duhet te** trajnohen per njohjen e rrezikut te zjarrit qe paraqesin proceset e punes dhe per menyren e venies ne pune te pajisjeve zjarfikse ne perdorim.

